



A.nr. 2067/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2067/2025, të datës 23.12.2025, të parashtruar nga ankuesja G.L, nga Prishtina, më objekt ankimor *“kundërshtim i masës disiplinore”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.2067/2025, e datës 23.12.2025, e parashtruar nga ankuesja G.L.

II. Anulohet Vendimi Nr. T-49/25, i datës 27.11.2025, i Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës, ndërsa, çështja kthehet **në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë**, me detyrimin që ky i fundit në ri procedurë të veproj në pajtim më pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendimi, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës të përkujdeset për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet lidhur me veprimet ndërmarra në kuptim të zbatimit të vendimit.

A r s y e t i m

Ankuesja G.L. (tutje referuar ankuesja), më datë 23.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr. T-49/25, të datës 27.11.2025, të Komisionit Disiplinor i Autoritetit të Konkurrencës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës së përgjithshme administrative dhe legjislacionit për Zyrtarët Publikë dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Autoritetin e Konkurrencës, ndërsa, kjo e fundit, më datë

ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës, duke dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8037/2025 të datës 23.12.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Procesverbalin e datës 24.10.2025 për takimin me palën në procedurë hetimore pronar ISP; Emailin e datës 20.05.2024 nga S.B për A.R, G.L dhe E.B; Emailin e datës 20.05.2024 nga A.R për G.L, S.B, E.B; Emailin e datës 20.05.2024 nga ankuesja për A.R, S.B dhe E.B; Emailin e datës 25.03.2025 nga ankuesin për A.M. E.T dhe S.B; Udhëzim për konsultim në me të ankueses i datës 21.03.2025; Emailin e datës 22.08.2025 nga S.B për ankuesen; Emailin e datës 22.08.2025, 21.08.2025 nga ankuesja për S.B; Procesverbali i seancës së Komisionit Disiplinor; Vendimi Nr. T-49/25 i datës 27.11.2025 i Komisionit Disiplinor; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses e datës 22.08.2025; Emailin e datës 27.10.2025 nga ankuesja për A.T; Emailin e datës 27.10.2025 nga A.T për ankuesen; Emailin e datës 25.11.2025 nga ankuesja për E.T; Emailin e datës 24.11.2025 nga E.T për ankuesen; Emailin e datës 31.10.2025 nga ankuesja për A.T; Emailin e datës 27.10.2025 nga ankuesja për E.T; Emailin e datës 12.08.2025 nga N.B për S.B; Emailin e datës 12.08.2025 nga ankuesja për S.B; Emailin e datës 11.04.2025 nga ankuesin për A.M, E.T, A.R, S.B, N.B; Emailin e datës 02.04.2025 nga A.M për G.L, N.K; Emailin e datës 01.04.2025 nga E.T për A.GJ, R.A, A.M, A.R; Emailin e datës 05.10.2024 nga E.T për N.B, S.B; Emailin e datës 26.12.2024 nga ankuesja për S.B, E.T, A.R, E.B; Emailin e datës 28.04.2025 nga ankuesja për N.B; Emailin e datës 28.04.2025 nga B.T për ankuesen; Emailin e datës 28.04.2025 nga ankuesin për B.T; Emailin e datës 30.07.2025 nga ankuesin për E.T, A.T, S.B, N.B, K.S, N.O; Emailin e datës 07.08.2025 nga A.B për ankuesen; Emailin e datës 06.08.2025 nga ankuesja për A.R; Emailin e datës 28.08.2024 nga A.R për G.L, E.B dhe F.Z; Emailin e datës 26.08.2024 nga ankuesin për E.BM F.Z, A.R; Emailin e datës 26.08.2024 nga .B për G.L, E.Z, A.R; Emailin e datës 01.08.2025 nga N.B për N.O, G.L, E.T, A.T, S.B; Emailin e datës 30.07.2025 nga N.O për G.L, E.T, A.T, S.B, K.S, N.B; Emailin e datës 12.08.2025 nga S.B për E.T dhe A.R; Lista e regjistrit të televizioneve të licencuara përmes operatorëve të shpërndarjes; Komunikimet me mesazhe përmes telefonit të ankese dhe Q.K; Dëshmi e pushimit mjekësor për ankuesen për datës 13.08.2025; Komunikimin me mesazhe telefoni mes ankueses dhe Sh....; Përgjigjen në ankesë e datës 05.01.2026; Akt Emërimit e datës 18.06.2025; Formulari i përshkrimit të punës për pozitën Inspektor Hetues i Konkurrencës; Vendimin e datës 27.08.2025 të Komisionit Disiplinor; Deklaratën e ankueses në Komisionin Disiplinor më datë 27.10.2025; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor datës 27.11.2025; Listën e dokumenteve të printuara nga ankuesja më datë 06.08.2025 dhe 07.08.2025.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton:

- Ankuesja sipas Aktit të Emërimit me Nr. AE-19/2025, të datës 18.06.2025, mbanë pozitën Inspektore Hetuese e Konkurrencës, në Autoritetin e Konkurrencës.

- Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, më datë 22.08.2025, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor të AKK-së me pretendimet se ankuesja ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.4, 4.5, 4.6, 4.7, 4.9, 4.12 dhe 4.14 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me arsyetimin se:... *lidhur me rastin IP Broadcast vs Artmotion ka takuar së paku tri herë privatisht palën në procedurë, respektivisht z. Q.K., në vendet: Bambo Caffè,-Ulqin, Proka Caffè-Prishtinë dhe Che Bar Caffè-Prishtinë, sipas deklarimeve znj. L, në këto takime i ka dhënë premtime palës në procedurë për kryerjen e rastit. Shkelje tjetër ka printuar 238 faqe në printerët e AKRK, me dokumente të ndryshme të cilat vetë znj. Latifi, i ka cilësuar si “konfidenciale”, për të cilët nuk ka dhënë shpjegim. Znj, L, nënkryetaren e thirret dhe e quan “kryetare”.*

-Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Konkurrencës, më datë 27.08.2025, ka nxjerr Vendim Nr. T-31/25, me të cilin ka shtyrë fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuses me arsyetimin se e njëjta është kandidatë për Kuvendin e Komunës së Prishtinës, në zgjedhjet lokale të vitit 2025 dhe i pezullohet pa pagesë vendi i punës nga data 05.09.2025 deri më datë 16.10.2025.

-Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Konkurrencës, më datë 27.11.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. T-49/25, me të cilin ka aprovuar të gjitha pikat e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, duke e shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore sipas me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.4, 4.5, 4.6, 4.7, 4.9, 4.13 dhe 4.20 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht, 4.2. *neglizhenca e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës. 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.* Rrjedhimisht, ankuses i është shqiptuar masa disiplinore “pezullimi nga pozita me ndalim prej 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës bazë për periudhën prej një (1) viti”.

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me Nr.T-49/25 të datës 27.11.2025 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Konkurrencës, me pretendimet se me rastin e procedurës disiplinore nuk i janë ofruar provat materiale të çështjes; Nuk është marr parasysh kërkesa për përjashtim nga procedura të kryetarit të Komisionit Disiplinor; Procedura disiplinore është zhvilluar si rezultat i ndikimit nga Kryetarja e Bordit; Nuk janë argumentuar me prova materiale pretendimet e iniciuesit të procedurës sepse në asnjë rrethanë dhe me asnjë provë nuk argumentohet se unë e kam quajtur nënkryetaren si kryetare, ndërsa kjo është bërë me qëllim të dëmtimit tim; Drejtori i Përgjithshëm ka qenë i informuar që kam bërë kallëzim penal ndaj tij, për të gjitha rastet që mi ka shkaktuar; Akuza për mos përfundim të rastit është e pavërtetë sepse rastin e kam kryer para një viti ndërsa vetë drejtori e ka penguar një gjë të tillë dhe kur kam pyetur për rastin nuk kam marr përgjigje; Drejtori sipas kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ka kërkuar pezullimin tim pa asnjë prove të vetëm e ku ndaj tij janë të ngritura dy aktakuza dhe i njëjtit nuk është pezulluar; Në asnjë rrethanë nuk kam informuar palën siç pretendohet për rastin sepse janë mesazhet në

telefon që nuk kam jap asnjë informacion dhe për këtë kam njoftuar eprorët e mi se pala më ka thirru në telefon; Pala në deklarimin e tij tek Drejtori i Përgjithshëm ka qenë kontrovers në raport me mesazhet e telefonit dhe absolutisht nuk qëndron deklarimet e kemi qëndruar bashkë jashtë institucionit kjo vërtetohet përmes mesazheve. Kërkon të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen ankimore, iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publike, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

- Neni 56, paragrafi 1 dhe 4: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civilë; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.*

- Nenit 57 paragrafi 2: *“Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.*

-Neni 61: *Parimet e individualizimit të masave disiplinore 1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera*

disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunës/it për shmangien apo kufizimin e dëmit.

Kolegji i Këshillit referuar kuadrit ligjor si me sipër, ka analizuar aktin e kundërshtuar në ndërlidhje me provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë dhe si rrjedhojë konstatoi se akti i kundërshtuar më ankesë është nxjerrë më vërtetim jo të drejtë të fakteve relevante dhe si pasojë është nxjerrë në kundërshtim më ligjin material, sepse, kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses është bërë mbi bazën e supozimit për shkelje disiplinore sipas nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.4, 4.5, 4.6, 4.7, 4.9, 4.12 dhe 4.14 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, konkretisht për shkak të shkeljeve disiplinore: 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4. 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; ndërsa, Komisioni Disiplinor përkundër që në pikën I të dispozitivit të Vendimit Nr.T-49/25 të datës 27.11.2025, ka aprovuar të gjitha kërkesat e datës 22.08.2025 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, në pjesën arsyetuese ka konstatuar shkelje tjera disiplinore gjegjësisht sipas Komisionit Disiplinor ankuesja ka kryer shkelje disiplinore sipas nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.4, 4.5, 4.6, 4.7, 4.9, 4.13 dhe 4.20 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, apo 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës. 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”. Pra, në vlerësim të Kolegjit dispozitivi i akti të kundërshtuar më ankesë është në kundërshtim me vet arsyetimin mbi arsyet se shkeljet disiplinore të konstatuara nga Komisioni Disiplinor nuk janë të njëjta më shkeljet disiplinore të pretenduara si në kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore.

Rrjedhimisht, Komisioni disiplinor në vendimin e kontestuar lidhur me shkeljen për mos përmbushje të detyrave të punës, neglizhencës në përmbushjes të detyrave të punës, mos përmbushjes në afat të caktuar dhe mos zbatimit të dispozitave ligjore në përfushje të detyrave, ka dhënë vetëm konstatime të përgjithshme duke cituar se sipas dokumentacionit ankuesja ka qenë e caktuar si bartësi e rastit të ISP Broadcast vs Artmotion, dhe se e për 19 muaj nuk është prodhuar asnjë dokument, ndërsa, Komisioni Disiplinor ka dështuar të vërtetojë faktet relevante si: kur ishte pashtuar kërkesa për trajtim nga ISP Broadcast vs Artmotion, cilat janë afat ligjore brenda të cilave ankuesja është dashur ta trajtoj rastin në fjalë, çfarë veprimesh ishin ndërmarr nga personat tjetër mbikëqyrës menaxhues kur rasti ishte mbajtur 19 muaj. Në fakt, në vlerësimin e Kolegjit në rast se nuk ka përmbushje të detyrave të punës atëherë është e pamundur që të vie në shprehje shkelja për moszbatim të dispozitave ligjore për përmbushje të detyrave të punës, pasi që, një shkelje e tillë do të ishte e mundur vetëm nëse ankuesja më rastin e përmbushjes nuk ka zbatuar drejtë ligjin material.

Ndërsa, ndërlidhur me shkeljet për printim të paautorizuar të 238 faqeve të dokumentacionit konfidencial të Autorit të Konkurrencës, po ashtu, Kolegji nga analizimi i aktit të kontestuar ka gjetur së Komisioni Disiplinor ka konstatuar së ankuesja ka printuar 238 faqe dokumentesh të cilësuar si koefidenciale dhe se njëjta nuk ka dhënë asnjë shpjegim zyrtar lidhur me arsyet, nevojën apo destinacionin e këtyre dokumenteve. Në vlerësimin e Kolegjit Komisioni Disiplinor serish ka dështuar në vërtetimin e dy fakteve relevante: llojin dhe natyrën dokumentacionin të kontestuar dhe ku dhe për kënd janë adresuar gjegjësisht këto dokumente ai janë barte jashtë objekti apo tek personat tjerë jo kompetent, dhe në anën tjetër edhe ankuesja ka detyrim ligjor që të saktësoj llojin e dokumentacionit dhe arsyet e printimit.

Andaj, nisur nga gjetjet dhe vlerësimet si më lart, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së për shkak të metave të konstatuar, vendosja meritore lidhur me këtë çështje disiplinore nuk është e mundur, kështu që, më qëllim të kthimit të ligjshmërisë e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj ankesën si të bazuar, anuloi Vendimin e kontestuar, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Konkurrencës, me detyrimin që ky i fundit të vërtetoj të gjitha faktet e identifikuar si në arsyetimin e këtij vendimi, të shpjegoj ri cilësimin e shkeljeve disiplinore, të garantoj parimet e mbrojtjes dhe ndihmës juridike, dhe të nxjerr vendim vetëm pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike dhe më zbatim të drejtë të ligjit material.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2067/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses G.L.;
- Autoritetit të Konkurrencës: Komisionit Disiplinor dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.